

INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE I STANDARDEVE

PROGRAMI I EDUKIMI FIGURATIV

KLASA VI

Tiranë, 2005

QËLLIMI

Programi i edukimit figurativ në klasën e gjashtë, ka për qëllim t'i formojë nxënësit për të kuptuar artin figurativ duke u shprehur nëpërmjet tij.

Objektivat e përgjithshëm

Në fund të klasës së gjashtë nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të prodhojë punë me dy dhe tri përmasa që komunikojnë ide (mendime, ndjenja, përvoja) për qëllime të caktuara dhe për një nivel të caktuar, duke përdorur lloje të ndryshme mjetesh, materialesh dhe teknikash;
- të identifikojë elementet e artit (ngjyrën, hijen, formën, hapësirën, sipërfaqen) dhe parimet e artit (theksin, balancën, ritmin, unitetin, përpjesëtimet) dhe t'i përdorë ato në mënyrë të përshtatshme për këtë nivel kur prodhon një punë arti;
- të shpjegojë dhe të interpretojë disa vepra arti, duke treguar si elementet dhe parimet e artit janë përdorur në to;
- të përdorë fjalorin dhe terminologjinë e duhur në përshtatje me këtë nivel.

Ky program i pajis nxënësit me njohuri, aftësi, qëndrime dhe vlera tashmë në një shkallë më të lartë vështirësie.

Ai i pajis me njohuri për: a) bazën materiale, proceset dhe teknikat, në realizimin e një pune artistike në përshtatje me këtë nivel; b) elemente dhe parime duke i rimarrë disa prej tyre në një shkallë më të lartë vështirësie, por edhe duke i ndërthurur me njohuri të reja; c) përdorimin e simboleve e tematikave të larmishme në shërbim të idesë; ç) historinë, kulturën, arkitekturën shqiptare dhe vepra nga artistë të artit botëror.

Aftësi për: a) identifikimin dhe përdorimin e elementeve e parimeve të artit në natyrë dhe në një vepër arti; b) identifikimin e ideve, të simboleve dhe të emocioneve që krijon një vepër arti e caktuar; c) përshkrimin e karakteristikave të një veprë arti, të një artisti në një periudhë të caktuar historike; ç) zbatimin e njohurive të artit të marra në këtë nivel në krijimtarinë e tyre artistike; d) vlerësimin e punës së vet dhe të shokut në përputhje me njohuritë e marra në këtë klasë; dh) të bashkëpunuar në grup duke respektuar mendimin e shokut, dhe për të mbajtur një qëndrim të caktuar ndaj artit.

Shkathtësi për: a) përdorimin i bazës materiale me rregull; b) përdorimin i një fjalori të parshatshëm artistik; c) të komunikuar ide, ndjenja, emocione.

Qëndrime për: a) të krijuar në mënyrë të pavarur në bazë të njohurive të marra në këtë nivel; b) të respektuar mendimin e tjetrit; c) të marrë përgjegjësi për punën që bën.

Vlera për: a) respektimin e traditave, të zakoneve dhe rivlerësimi i tyre në ditët e sotme; b) realizimin e detyrave të klasës dhe të shkollës me përgjegjësi.

STRUKTURA E PROGRAMIT

Ky program është mbështetur mbi 6 linja, të cilat krijojnë një bazë të fuqishme për të arritur objektivat kryesorë të të mësuarit:

1. Baza materiale, procese, teknika;
2. Parime dhe elemente;
3. Tematika;
4. Historia dhe kultura;
5. Analiza, interpretimi, vlerësimi;
6. Lidhjet ndërlëndore me jetën e mjedisin.

Përmbajtja e linjave

Baza materiale, procese, teknika

Me këtë linjë nxënësit tashmë janë njohur dhe janë aftësuar në përdorimin e materialeve dhe të teknikave që kanë njohur përgjatë ciklit fillor. Në këtë klasë ata janë më të vetëdijshëm në zgjedhjet e tyre artistike, në përdorimin e bazës materiale, të teknikës dhe të procesit. Ata janë në gjendje të njohin teknikat e ndryshme që janë përdorur nëpër vepra të ndryshme artistike nga artistë të ndryshëm.

Parime dhe elemente

Kjo linjë përfshihet në programin e çdo klase. Nëpërmjet saj nxënësit kanë njohur të gjitha elementet dhe parimet e artit. Ato elemente e parime shtrihen në tërë programin dhe janë skelet i kësaj linje. Në klasën e gjashtë një pjesë e njohurive të elementeve dhe të parimeve rimerren në një shkallë më të lartë vështirësie, ndërsa një pjesë e tyre vijonë me koncepte të reja. Në këtë klasë me nxënësit përsëriten njohuritë që kanë marrë, dhe rriten kërkesën për përdorimin dhe zbatimin e tyre, gjithmonë pa kaluar kufijnjtë e psikologjisë dhe kërkesave të moshës.

Njohurit e reja që do të merren, nxënësi do t'i demonstrojë:

- në krijimet e tij;
- në analizën që do t'u bëjë veprave të ndryshme të artit;
- në analizën që do t'u bëjë realizimit të elementeve e parimeve në krijimet e tij, nëpërmjet bazës materiale e teknikës së duhur.

Tematika

Kjo linjë zhvillon më tej aftësitë e nxënësve në punët e tyre krijuese, përmes përdorimit të tematikave të larmishme në bazë të aftësisë së tij përzgjedhëse dhe të përdorimit të shumëllojshmërisë së burimeve duke shprehur mendimin dhe qëndrimin e tij ndaj dukurive. Në tematikat e ndryshme nxënësi do të përzgjedhë dhe do të përdorë të gjitha elementet dhe parimet që ka mësuar deri tani, do të përzgjedhë bazën materiale e teknikën e duhur në shërbim të temës, do të komunikojë ndjenjat dhe mendimet e tij nëpërmjet temave të ndryshme.

Historia dhe kultura

Përmes kësaj linje nxënësi do të njihet me artin, historinë e kulturën e vendit tonë dhe të vendeve të tjera. Ai do të njihet me artistë e vepra të tyre në kohë e vende të ndryshme. Kjo linjë e ndihmon nxënësin të njohë veprat e artit dhe t'i analizojë ato. Gjatë klasës VI nxënësi do të vazhdojë të njihet me artistë të ndryshëm, si dhe do të rimarrë vepra arti të njohura më parë, duke i riparë me një këndvështrim të ri. Njohja me arkitekturën e spikatur të vendit tonë, si: e Beratit, Gjirokastrës etj., është pjesë e përmbajtjes së kësaj linje.

Analiza, interpretimi dhe vlerësimi

Kjo linjë edhe në këtë nivel, ndërthuret organikisht me linjat e tjera. Për çdo njohuri që merr, nxënësit i duhet të vëzhgojë, të përshkruajë, të analizojë, të interpretojë dhe të vlerësojë. Edhe në klasën VI kjo linjë është mjaft e rëndësishme për zhvillimin e aftësive komunikuese të nxënësve. Shkalla e vështirësisë së analizës dhe të vlerësimit rritet më shumë në këtë klasë. Nxënësit do të analizojnë dhedo të vlerësojnë më me përgjegjësi punët e tyre dhe të shokut, do të analizojnë elementet dhe parimet e njohura në një vepër arti, teknikën, idenë dhe mesazhin që ajo përcjell. Një vend mjaft të rëndësishëm zë përdorimi i një fjalori të thjeshtë artistik, gjatë analizës së një vepr arti.

Lidhjet ndërlëndore me jetën e mjedisin

Do të shërbejë për të treguar lidhjen që ka ky art me llojet e tjera të artit dhe lidhjen e ngushtë që ka arti me mjedisin ku ai zhvillohet. Por në këtë klasë rritet vështirësia e konceptit të këtyre lidhjeve në përshtatje me moshën, pasi edhe aftësia perceptuese e nxënësit është më e madhe. Në këtë linjë nxënësi:

- Rrit aftësinë vëzhguese ndaj dukurive artistike në art dhe në jetën e përditshme;
- Vlerëson objektet artistike;
- Vlerëson në një mënyrë më të plotë vlerat artistike popullore.

PROGRAMI ANALITIK PËR KLASËN E GJASHTË

35 javë x 1 orë = 35 orë

| | |
|--|--------|
| 1. Baza materiale, procese e teknika | 5 orë |
| 2. Elemente dhe parime | 16 orë |
| 3. Tematika | 2 orë |
| 4. Histori dhe kulturë | 3 orë |
| 5. Analiza, interpretimi , vlerësimi | 3 orë |
| 6. Lidhjet ndërlëndore dhe me mjedisin | 4 orë |
| 7. Orë në dispozicion | 2 orë |

Linja I. Baza materiale, proceset, teknikat **5 orë**

Nxënësi duhet të njohë, të përzgjedhë dhe të përdorë materiale, mjete, procese e teknika. Ai duhet:

- Të aftësohet në përdorimin e bazës materiale, të teknikave dhe proceseve që do të përdoren në këtë klasë, si: lapsi, letra, goma, ngjitësi, akuareli, vizatimi,

tempera, kolazhi, instalacioni, pastelina, stampimi, skulptura, fotografia, kompjuteri etj.

- Të përzgjedhë bazën materiale dhe teknikën e përshtatshme për të ilustruar njohuritë e marra tek elementet dhe parimet, p.sh.:
 - të përdorë lapsin dhe teknikën e vizatimit për të modeluar formën;
 - të përdorë temperat për të krijuar vlerat e ngjyrave;
 - të përdorë kolazhin për të ilustruar njohuritë për sipërfaqen;
 - të përdorë plastelinën për të krijuar vëllimin etj.
- Të përdorë bazën materiale, teknikën dhe proceset për të komunikuar ndjenja e emocione.

Linja II. Elemente dhe parime

16 orë

Nxënësi duhet të njohë e të përdorë elementet e parimet e artit në punimin e tij. Ai duhet:

- Vijat:
 - të gjejë vijat në një punë artistike duke shpjeguar si ndikojnë karakteristikat specifike të vijës në gjendjen e kompozimit – *(bisedë e ilustruar me vepra arti psh. "Krijimi" nga Mikelanxhelo, skica me rapid për të krijuar emocione të ndryshme);*
- Format dy-përmasore:
 - të njohë format e sakta (2-përmasore) gjeometrike dhe format manuale (të krijuara nga dora), përdorimin e tyre në kompozim - *(bisedë, vëzhgim krijim);*
- Format tre-përmasore:
 - të vëzhgojë format gjeometrike (3-përmasore) dhe organike, duke kuptuar lidhjen e ngushtë të formës dhe të vëllimit - *(krijim me plastelinë);*
- Vlera:
 - të njohë dritëhijen si vlerë – *(natyrë e qetë: sfera dhe kubi);*
- Sipërfaqja:
 - të njohë që të gjitha objektet në natyrë kanë një cilësi të sipërfaqes dhe të materialit – *(bisedë dhe krijim në teknikën e pastelit ose të kolazhit);*
- Ngjyra:
 - të njohë tri emërtimet e ngjyrave:
 - emërtimi i ngjyrave
 - vlerat: të çelëta / të erëta
 - intesiteti: të ndriçuara/të turbullta - *(bisedë e ilustruar me punë krijuese);*
- Hapësira:
 - të njohë e të analizojë efektin e bashkimit të qiellit, të tokës dhe të objekteve që ndodhen në të, në një vepër arti – *(rruga me pemë në perspektivë);*
- Barazpesha:
 - të njohë barazpeshën në një vepër arti dhe ta përdorë atë në krijimet e tij – *(fotografi artistike);*
- Theksi dhe lëvizja:

- të njohë e të përdorë efektet që krijojnë theksin, p. sh., kontrasti, si dhe lëvizjen nëpërmjet vendosjes së elementeve – (*krijë theksin duke vënë në qendër figurën kryesore*);

- Uniteti:
 - të njohë unitetin si parim i artit – (*krijim varsja, byzylyku për ditën e nënës*);
- Kontrasti:
 - të vëzhgojë dhe të gjejë kontrastin në mjedisin rrethues – (*bisedë*);
- Harmonia:
 - të kuptojë që përsëritja e elementeve, si: forma, vija, ngjyra, krijojnë harmoninë në kompozim - (*krijim formal me motive floreale, në mozaik, stampim, etj.*).

Linja III. Tematika

2 orë

Nxënësi duhet të shqyrtojë, të përzgjedhë dhe të përdorë shumëllojshmëri temash, simbolesh, idesh nga jeta e tij personale. Ai duhet:

- të përzgjedhë bazën materiale dhe teknikën në shërbim të temës;
- të komunikojë ndjenja e mendime nëpërmjet temave të larmishme – (*krijim, punë në grup ku nxënësit zgjedhin një temë të caktuar*).

Linja IV. Historia dhe kultura

3 orë

Nxënësi të kuptojë edukimin figurativ në lidhje me historinë dhe kulturën. Ai duhet:

- të njohë artistë shqiptarë në periudha të ndryshme, si dhe veprat e tyre - (*bisedë - artistë të periudhës së Rilindjes si Kolë Idromeno, Simon Rrota*);
- të njohë arkitekturën e spikatur shqiptare (Berat, Gjirokastër etj.);
- të dallojë artistë të periudhave të ndryshme të historisë së artit dhe veprimtarinë e tyre artistike (*përfaqësues të Rilindjes italiane dhe të impresionizmit si Leonardo da Vinci, Mikelanxhelo, Rafaelo, Mone, Sezan*).

Linja V. Analiza, interpretimi, vlerësimi

3 orë

Nxënësi duhet të vëzhgojë, të përshkruajë, të analizojë, të interpretojë dhe të vlerësojë punimet e tij dhe të shokut. Ai duhet:

- të analizojë dhe të vlerësojë preferencat artistike të tij dhe të shokut;
- të analizojë elementet dhe parimet, teknikën, idenë dhe mesazhin që ajo përcjell në një vepër arti, duke përdorur fjalorin e duhur artistik;
- të bëjë dallimin ndërmjet një veprë arti origjinale dhe një veprë të riprodhuar.

Linja VI. Lidhja ndërlëndore dhe me mjedisin

4 orë

Nxënësi duhet të bëjë lidhjet mes artit figurativ dhe disiplinave të tjera në jetën e përditëshme. Ai duhet:

- të njohë dhe të vlerësojë se çfarë e bën një objekt vepër arti: - (*bisedë*);
- të njohë traditat, zakonet dhe vlerat artistike popullore: - *shikon filma dokumentarë, albume, libra artistikë etj.*;

- të njohë dhe të bëjë lidhjen e edukimit figurativ me lloje të tjera të artit, si me letërsinë për ilustrimin e një pjese letrare – (*muzikën, shkencat, etj.*).

METODOLOGJIA E REALIZIMIT TË PROGRAMIT

Në qendër të metodologjisë së lëndës së edukimit figurativ është përvoja dhe aftësia e nxënësit, të cilat i formon, i përmirëson dhe i edukon vazhdimisht gjatë procesit mësimor dhe jashtë tij. Duhet pasur parasysh që në këtë klasë nxënësi vjen me një përvojë dhe aftësi të formuar për moshën nga programi i edukimit figurativ të ciklit të fillor (klasat I – V). Mësuesi duhet të përdorë forma të larmishme, si:

- vëzhgimi,
- ilustrimi,
- zbërthimi i saktë i temës dhe njohurive,
- nxitja e veprimtaria e drejtuar,
- veprimtaria e pavarur,
- zgjerimi i njohurive për konceptin e marrë,
- vlerësimi artistik etj.

Karakteristikë e rëndësishme në këtë klasë, si në të gjithë programin, është liria vetjake në krijim, e cila do të thotë që nxënësi të zbatojë njohuritë e marra nga programi duke ua përshtatur stilit të tij të punës dhe ëndërrimeve të tij.

Është shumë e rëndësishme që bashkëpunimin mësues–nxënës gjatë procesit mësimor të mbështetet edhe në përvojën vetjake të nxënësve.

VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënësve në këtë nivel do të bëhet në bazë të arritjeve që realizon në veprimtarinë praktike e krijuese, në atë sa ai arrin të realizojë në praktikë njohuritë e marra. Një mënyrë tjetër vlerësimi është edhe aftësia analizuese e vlerësuese që nxënësi i bën punës së tij, të shokut apo edhe një veprë arti. Ky lloj vlerësimi mund të jetë edhe orë më vete kur kemi analizën e veprave të artit, por mund të jetë edhe në fund të një teme të caktuar, kur në diskutim marrin pjesë të gjithë nxënësit. Vlerësimi mund të bëhet ose jo pas çdo teme mësimore ku mësuesi duhet të japë opinionin e tij për çdo krijim të nxënësit. Vlerësimi bëhet në kolonë, si edhe në mënyrë individuale.

INTEGRIMI

Nëpërmjet artit figurativ nxënësit do të dallojnë lidhjet e kësaj fushe arti me llojet e tjera të artit, me lëndët e tjera mësimore dhe me mjedisin ku zhvillohet. Kjo lëndë tregon sesa i lidhur është arti figurativ me jetën tonë të përditshme, duke u siguruar mundësinë nxënësve që të krijojnë punë të ndryshme, duke ndërthurur artin pamor me forma të tjera të artit. Kështu, për shembull, nxënësi mund të krijojë mbasi ka dëgjuar një pjesë muzikore, mund të lidhë një datë historike me një etapë të zhvillimit të edukimit figurativ etj.

MJETET DHE PËRDORIMI I TYRE

Përdorimi i mjeteve në punimin artistik është i domosdoshëm për të arritur një nivel të kënaqshëm gjatë veprimtarisë mësimore. Është shumë e rëndësishme që çdo nxënës të ketë kutinë e tij të mjeteve të punës. Në pamundësi të plotësisht të çdo nxënësi me mjete vetjake, mund të përdoren mjetet në grup.

Mjetet më të rëndësishme janë :

Grupi i parë: shkumsa me ngjyra (tetë ngjyra), lapsa me ngjyra, gomë dhe laps i zi HB, lapustila, akuarelet, pastela.

Grupi i dytë: vinovilë, letërngjitëse, skoç, vizore, gërshërë.

Grupi i tretë: penela të ndryshme të disa madhësive, të cilat janë të përcaktuar në paketa të veçanta, fletore vizatimi, fletore punëdore, letë tabak, kartona me ngjyra, letër për të shkruar A₄.

Grupi i katërt: aparat fotografik, (një për të gjithë klasën), kompjuter (sipas mundësive).

Grupi i pestë: mbajtëse për dosjet e punës, mbajtëse për mjetet, enë për të mbajtur ujë për pastrimin e penelave, si dhe për krijimin e ngjyrave me tempera, akuarela.

Grupi i gjashtë: mjete për pastrimin, peshqirë të vegjël, kartëpeceta, gazeta.

Vendi i punës

Për të zhvilluar mësimin e edukimit figurativ, është shumë e rëndësishme që nxënësi të punojë me një dritë të plotë, me një vend të sigurt ku t'i mbështes mjetet e tij, në një vend të ngrohët e pa lagështirë, të pastër. Vendi më i mirë për orën e edukimit figurativ është klasa-studio. Në pamundësi të saj, klasa të ketë kushtet e përshtatshme.

KRITERE PËR HARTIMIN E TEKSTEVE NË LËNDËN EDUKIM FIGURATIV PËR KLASËN VI

Krijimi i një teksti mësimor për lëndën e edukimit figurativ në shkollën tonë sot është një domosdoshmëri, e cila përcillet nga zhvillimet e shoqërisë në përgjithësi, por edhe asaj të kurrikulës së edukimit figurativ që zbatohet sot. Përsa i takon formimit të nxënësit, ky tekst do të ndihmonte shumë në formimin e tij të përgjithshëm artistik:

- duke krijuar njohuri teorike të qëndrueshëm,
- duke dhënë mbështetje ilustrative,
- duke dhënë modele për analizat, vlerësimin, nxitjen e mendimit kritik nëpërmjet debateve, bisedave e vlerësimeve,
- duke pasuruar fjalorin artistik etj.

Puna e institucioneve dhe e grupeve të autorëve që do të marrin përsipër hartimin e teksteve për klasën e dytë dhe të gjashtë të arsimit të detyruar të shkollës sonë është e domosdoshme të përqendrohet në plotësimin e disa kriterëve që kanë të bëjnë si me këndvështrime të përgjithshme, ashtu edhe me këndvështrime më specifike shkencore e didaktike, të cilat do të paraqiten në vijim.

I. PARIME TË PËRGJITHSHME

Teksti shkollor ka qenë dhe vazhdon të jetë një instrument i frytshëm i procesit mësimor. Për këtë arsye, tekstet e nxënësit të paraqesin veçori si në trajtimet përsa i takon konceptimit të përmbajtjes, ashtu edhe në formën e paraqitjes.

Hartimi i teksteve është proces. Ai duhet:

- a) Të bazohet dhe të jetë në përputhje të plotë me paketën zyrtare të lëndës shkollore dhe në veçanti me programin e reformuar dhe standardet lëndore;
- b) Të marrë parasysh përvojën e deritanishme të shkollës tonë dhe përvojat pozitive të vendeve të tjera;
- c) Të mbështetet në përvojat e praktikës së drejtpërdrejtë shkollore, duke përdorur metoda të ndryshme për tërheqjen e mendimit të nxënësve dhe mësuesve në këtë nivel;
- ç) Të respektojë veçoritë e zhvillimit mendor dhe fizik të fëmijës;
- d) Të synojë nxitjen e ideve të reja në procesin e mësimdhënies dhe të nxënësve krijimin
- dh) Të synojë realizimin e një dokumenti të hapur që i lë vend mësuesit për zhvillime krijuese si në përmbajtje, ashtu edhe nga ana metodike.

Teksti i lëndës së edukimit figurativ synon të sjellë në klasë, në miniaturë, mjedisin kulturor e artistik, në të cilin jetojnë nxënësit. Ai të krijojë lidhje të fuqishme bashkëpunimi krijues: nxënës - nxënës, mësues - nxënës, mjedis shkollor e jashtëshkollor.

Çështje të hatimit të tekstit (katalog ilustrues)

1.- Teksti i lëndës së edukimit figurativ, si libër shkollor, të jetë në përputhje me programin konkret të miratuar nga MASH. Ai duhet të përmbushë të gjithë objektivat mësimorë e pedagogjike që përmbahen në të. Në këtë mënyrë teksti t'u pëmbahet qëllimeve të sistemit arsimor, në përgjithësi, dhe të programit, në mënyrë të veçantë. Kjo gjë nënkupton mbajtjen parasysh të qëllimeve në dy nivele:

a) të qëllimeve të shprehura hapur në program. Pra, në tekst të përfshihen ato informacione dhe të mundësohen ato veprimtari, të cilat synojnë të arrijnë qëllimin e shprehur në program;

b) të qëllimeve të nënkuptuara. Autorët e teksteve të studiojnë dhe të zbulojnë atë sistem vlerash, në të cilat mbështetet një sistem arsimor demokratik. Teksti nga ana e tij, si i tërë, të mundësojë realizimin e qëllimeve të tilla, të cilat në shumë raste janë edhe themelore.

2. Teksti nuk është thjeshtë përkthim i programit, që ka karakter sa detyrues aq edhe udhëzues, por përdoret për studim vetjak. Autorët, duke patur një konceptim të qartë të procesit mësimor dhe të perceptimit të tyre për përmbajtjen e lëndës, mund të kthehen në një faktor nxitës në mësimdhënien e lëndës së edukimit figurativ. Në këtë drejtim autorët mund të shfrytëzojnë:

a) hapësirat e programit (orët në dispozicion ose përsëritjet)

b) aparatit pedagogjik të tekstit, i cili më shumë se çdo tjetër kufizon ose zgjeron mundësitë e përvetësimit të objektivave të lëndës.

3. Ndërtimi i tekstit të nisët nga parimi se nxënësi fiton njohuri nga veprimtaria e tij. Hartuesit e tij të krijojnë kushte të tilla që nxënësi të veprojë duke u nxitur nga sa më shumë fusha ndijore dhe veçanërisht mendore. Vetëm kështu nxënësi merr njohuri të zbatueshme.

4. Të gjenden zgjidhje të frytshme në tekst që mësuesi të përçojë njohuritë në mënyrë sa më të saktë.

5. Të mbështetet në kërkesat didaktike të shkollës së sotme, duke përcjellë dhe përvojën bashkëkohore.

TEKSTI SHKOLLOR

Teksti shkollor të mundësojë realizimin e objektivave në fushën e njohurive, të shprehive dhe të qëndrimeve.

Kjo do të thotë që teksti duhet të ofrojë, si për nxënësit ashtu edhe për mësuesit, krijimin e situatave mësimore që mundësojnë realizimin e objektivave të mësipërm. Këtu duhet të kujtojmë se veprimtaritë praktike nuk mund të shihen të ndara nga veprimtaritë krijuese.

- Është mirë që nxënësit të aktivizohen më parë në veprimtari praktike të tilla, si: vëshgimi, grumbullimi i matreialit paraprak nga nxënësi, biseda, vizitat, në ekspozita, galeri, vende me arkitekturë të veçantë, shikim filmash, vizita në ndërmarje artistike, studio arti.
- Sistemimi i dijeve në tema e në nëntema që t'i ndihmojë nxënësit të zbërthejnë faktet nëpërmjet ushtrimit dhe të caktohen në tekst burime të tjera të informacionit,

Ushtrimet të jenë të tilla:

- ndijore (me albume pikturash, me punime të ndryshme artistike, me harta, me video, me filma).
- veprimtari praktike (me një bazë të caktuar materiale si dhe me një teknikë të caktuar).
- veprimtari shprehëse (me shkrim, me gojë, me krijim artistik).
- veprimtari mendore (analiza, veçimi, krahasimi, dallimi, sinteza, klasifikimi, përgjithësimi, zgjerimi i argumentit), nxjerrja e përfundimit etj.

Ushtrimet të planifikohen të tilla që të përforcojnë përmbajten, të kenë material njohës e ilustrues. Veprimtaria ndijore të përfshijë ilustrimet me punime të ndryshme artistike. Për këtë arsye është mjeshtëria e autorit të tekstit që të parashikojë ato veprimtari që mundësojnë realizimin në tërësinë e tyre të synimeve dhe të objektivave të lëndës.

4) Sistemi i pyetjeve në fund të njësisë mësimore të ofrojë mundësinë (autorët mund të përdorin edhe forma të tjera):

Që nxënësit:

- në mënyrë të pavarur të përvetësojë informacionin e tekstit;
- të dallojnë atë çka është thelbësore nga ajo që nuk është e tillë, në varësi të objektivave të njësisë mësimore dhe të objektivave të programit;
- të përfshihet në veprimtari krijuese që synojnë të zhvillojnë aftësitë krijuese dhe artistike etj;
- të krijojnë mendimin dhe qëndrimet e tyre të pavarura, të mbështetura me argumente, por të pranojnë, të respektojnë dhe të marrin parasysh argumentet e të tjerëve.

Që mësuesit:

- të zgjedhin metodat ndërvepruese më të përshtatshme për realizimin e objektivave të lëndës së edukimit figurativ ;

- të planifikojnë më mirë orën e mësimit;
- të mundësojnë vënien e nxënësve në kushte të barabarta të nxëni;
- të mundësojnë nxënësit të përqendrohen në çështjet kryesore të temës mësimore;
- të mundësojnë nxënësit të shfrytëzojnë njohuritë e tyre paraprake ose të përvetësuara gjatë procesit mësimor që janë të domosdoshme për përvetësimin e njohurive dhe të shprehive të reja;
- të vlerësojnë realizimin e objektivave të njësive mësimore dhe nivelet e përvetësimit të tyre nga nxënësit etj.

5) Teksti të përmbajë mësimet ose struktura mësimi të qarta, në formën e njësive mësimore, për të arritur objektiva të qartë mësimore në përputhje me programin e dhënë ose me standardet lëndore.

6) Po kështu, në tekst mund të shfrytëzohet ose të nxitet edhe mundësia e marrjes së informacioneve të caktuara shtesë nga burime të tjera informacioni (tekste, shembuj didaktikë, foto të piktorëve, ekspozita, piktura të fëmijëve bashkëmoshatarë apo më të rritur, pamje të ndryshme të përdorimit të artit në mjediset familjare, në punë, shkollë, në zbukurimin e mjedisit me mjete të krijimit të artit me dy e tri përmasa, të arti elektronik dhe ndikimet e tij në jetën e njeriut), gjë që do të bënte tekstin ose njësinë mësimore më të hapur dhe më pak monotone, duke rritur edhe mundësitë e punës së pavarur vetjake kërkimore të nxënësve.

5) Gjuha e teksteve të jetë e thjeshtë, e kuptueshme, e pangarkuar me terma e terminologji në gjuhë të huaja ose që bartin kuptime të ndryshme.

6) Nëse në tekst përdoren ilustrime, ato të bartin vlera kuptimore dhe emocionale që lidhen ngushtë me motivimin e nxënësve, me përmbajtjen e njësive mësimore ose me objektiva të tjerë të programit.

7) Nga pikëpamja sasiore, autorët e teksteve të shmangin informacionet e tepërta, të përsëritura etj., që shpesh krijojnë mbingarkesë tek nxënësit, të cilët jo gjithmonë janë në gjendje të dallojnë informacionin kryesor nga ai që nuk është i tillë në raport me kërkesat e programit ose të njësisë mësimore. Autorët të bëjnë kujdes që të mos krijojnë mbingarkesë edhe në dhënien e koncepteve. Mbingarkesa krijohet jo vetëm nga numri i madh i koncepteve që jepen në një njësi mësimore, por edhe nga pamundësia e sqarimit të tyre në kushtet e kufizimit sasior (informacionit) dhe kohor të njësisë mësimore. Informacionet shtesë (ilustrimet, fotot, tekstet, grafikët, shembujt didaktikë të edukimit figurativ etj.) t'i shërbejnë sqarimit më të mirë të koncepteve.

8) Njësia mësimore e tekstit të ketë një strukturë që të lejojë përmbushjen e funksioneve të tekstit, si dhe pasqyrimin e veçorive të përmbajtës së temave të veçanta, p.sh., mësimet përsëritëse mund të hartohen të tilla që të japin një përsëritje ilustrative të konceptit apo të hartuar në formën e një gjëze figurative. Mësimet për vlerësimin artistic të kenë një model dhe kritere të vlerësimit, pyetësorë për nxitjen e mendimit.

9) Struktura e ndarjeve të tekstit, si dhe struktura e njësisë mësimore të tekstit (p.sh., tema) të jenë të njësuara gjatë gjithë tekstit.

10) Faqosja e elementeve të ndarjeve mësimore (titujt, tekstet, ilustrimi figurativ, pyetësori, modelet, gjëza figurative etj.) të jenë tërheqëse dhe të mbështetura në procedurën logjike të shtjellimit të lëndës, në përgjithësi, dhe temës, në veçanti.

11) Përdorimi i hapësirave, nënvizimeve, sqarimeve, ngjyrave etj., të jetë në shërbim të çështjes që trajtohet.